

PAGA MINIMIALE 500 EURO

Hap i nevojshëm, por jo i
mjaftueshëm

DOKUMENT POLITIKASH

INSTITUTI PËR POLITIKA SOCIALE MUSINE KOKALARI
KORRIK 2026

Përmbledhje ekzekutive

Instituti për Politika Sociale “Musine Kokalari” e mirëpret hyrjen në fuqi të pagës minimale bruto prej 500 eurosh, si një masë të rëndësishme për përmirësimin e pozitës së punëtorëve me pagat më të ulëta në Kosovë. Një person që punon me orar të plotë duhet të marrë një pagë që i siguron një nivel minimal të sigurisë ekonomike dhe dinjitetit.

Megjithatë, paga minimale nuk duhet të trajtohet si masë e izoluar. Ajo duhet të shoqërohet me transparencë në formulën e përcaktimit, rol real të dialogut social, monitorim të fuqishëm nga institucionet përgjegjëse dhe politika më të gjera për rritjen e cilësisë së vendeve të punës. Pa këto masa, rritja rrezikon të mbetet formale për një pjesë të punëtorëve dhe të krijojë presione të reja në strukturën e pagave.

Ky dokument synon të vlerësojë përfitimet, rreziqet dhe hapat e nevojshëm pas hyrjes në fuqi të pagës minimale prej 500 eurosh bruto.

Konteksti dhe problemi politik

Instituti për Politika Sociale “Musine Kokalari” e mirëpret hyrjen në fuqi të pagës minimale bruto prej 500 eurosh, si një masë të rëndësishme për përmirësimin e pozitës së punëtorëve me pagat më të ulëta në Kosovë. Një person që punon me orar të plotë duhet të marrë një pagë që i siguron një nivel minimal të sigurisë ekonomike dhe dinjitetit.

Megjithatë, paga minimale nuk duhet të trajtohet si masë e izoluar. Ajo duhet të shoqërohet me transparencë në formulën e përcaktimit, rol real të dialogut social, monitorim të fuqishëm nga institucionet përgjegjëse dhe politika më të gjera për rritjen e cilësisë së vendeve të punës. Pa këto masa, rritja rrezikon të mbetet formale për një pjesë të punëtorëve dhe të krijojë presione të reja në strukturën e pagave.

Konteksti dhe problemi politik

Për një kohë të gjatë, pagat e ulëta në Kosovë janë trajtuar si rezultat i pashmangshëm i strukturës ekonomike, e jo edhe si pasojë e fuqisë së dobët negociuese të punëtorëve, organizimit të kufizuar sindikal dhe një modeli ekonomik që mbështetet tej mase në fuqi të lirë punëtore.

Vendimet për pagën minimale në vete bartin një problem real për sa i përket organizimit sindikal, meqë e përjashtojnë thuaja se tërësisht Këshillin Ekonomik-Social dhe merren drejtpërdrejt nga ekzekutivi. Një vendimarrje e tillë, përveç se çalon në aspektin demokratik, e vështirëson edhe zbatimin meqë as përfaqësuesit e punëtorëve si përfitues, e as përfaqësuesit e punëdhënësve, si pagues, nuk janë pjesë e procesit dhe konsultimit. Po ashtu, ka kohë që vendimet e qeverisë për pagën minimale ngjasojnë në vendime arbitrare meqë nuk qartësohet në mënyrë transparente se cilat kriterë e faktorë janë marrë parasysh për caktimin e nivelit të saj. nuk tregojnë formulën e përdorur për të arritur deri te shuma e caktuar. Sipas nenit 57 të Ligjit nr. 03/L-212 për Punën, paga minimale duhet të përcaktohet duke marrë parasysh:

Paga minimale duhet të ketë transparencë në mënyrë që debatet për të të jenë më mirë të informuara dhe të bazuara në të dhëna të sakta. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të vlerësuar nivelin e pagës minimale, por edhe për të kuptuar ndikimin që ajo ka te punëtorët, punëdhënësit, sektorët ekonomikë dhe buxheti publik.

koston e shpenzimeve jetësore

përqindjen e shkallës së papunësisë;

gjendjen e përgjithshme të tregut të punës;

nivelin e konkurrueshmërisë dhe produktivitetit në vend.[1]

[1] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90, 1 dhjetor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

Përfitimet e pagës minimale prej 500 eurosh

Rritja nga 350 në 500 euro përfaqëson një rritje prej 42.9%. Sipas vlerësimeve të publikuara nga Instituti GAP, nga rritja në dy faza gjatë vitit 2026 pritet të përfitojnë mbi 130,000 punëtorë me orar të plotë, ose rreth 36% e të gjithë të punësuarve me orar të plotë. Kostoja shtesë e drejtpërdrejtë për punëdhënësit vlerësohet të kalojë 85 milionë euro, që përbën afërsisht 2% të fondit të përgjithshëm të pagave në Kosovë.^[2]

Këto të dhëna dëshmojnë njëkohësisht rëndësinë sociale të masës dhe shkallën e sfidës së zbatimit të saj. Për punëtorët me të ardhura të ulëta, paga minimale më e lartë rrit të ardhurat mujore, ul presionin mbi familjet me të ardhura të kufizuara dhe krijon një standard më të qartë ligjor për punën me orar të plotë.

Në këtë kuptim, vendimi është hap pozitiv drejt njohjes së punës dhe dinjitetit të punëtorëve që për një kohë të gjatë kanë mbetur në fund të shkallës së pagave. Paga minimale nuk është vetëm instrument ekonomik. Ajo është edhe instrument social, sepse përcakton kufirin nën të cilin puna e rregullt nuk duhet të paguhet.

Krahasimi me BE-në dhe rajonin

Kjo masë po ashtu ngre një çështje domethënëse në raport me punësimin në përgjithësi në Kosovë. Në komunikimet publike të ekzekutivit thuhet se nga rritja e pagës minimale do të përfitojnë rreth 150,000 të punësuar në Kosovë,^[3] që bart një shpërputhje me të dhënat e publikuara nga Instituti GAP.^[4] Sidoqoftë, si përqindje rreth 36% të punësuarëve preken nga paga minimale, që është një përqindje shumë e lartë. Sa për ilustrim vendet e Bashkimit Evropian sillen prej 3 deri në 13%.

Për krahasim, në Shqipëri, sipas INSTAT, në tremujorin e parë të vitit 2026, 26.7% e të punësuarve ishin në grupin e pagave deri në pagën minimale. Ndërsa në Serbi, sipas Ministrisë së Financave, rreth 91,000 të punësuar marrin pagën minimale^[5] Kjo tregon shumë për gjendjen e punësimit në përgjithësi dhe strukturën e ekonomisë sonë: strukturë kjo e cila bazohet në vende pune pa kualifikime, ose me kualifime të ulëta. Ky lloj punësimi shkakton pastaj një zinxhirë të efekteve negative në ekonomi dhe në tregun e punës. Prandaj lufta për më shumë vende pune duhet të bëhet krahas luftës për më shumë vende të kualifikuara të punës.

[2] Instituti GAP, *Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale në vitin 2026?* (Prishtinë: Instituti GAP, janar 2026), https://www.institutigap.org/documents/83097_Pagamiminimale.pdf

[3] KOHA.net, "Kurti: Nga rritja e pagës minimale përfituan 150 mijë punëtorë të sektorit privat," 1 korrik 2026, <https://www.koha.net/arberi/kurti-nga-rritja-e-pages-minimale-perfituan-150-mije-punetore-te-sektorit-privat>

[4] Instituti GAP, *Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale.*

[5] INSTAT, *Wage Statistics: Quarter I 2026* (Tiranë: Instituti i Statistikave, 10 qershor 2026), 2, <https://www.instat.gov.al/media/jede25r3/wage-statistics-q1-2026.pdf> Ministry of Finance of the Republic of Serbia, "Siniša Mali: Nakon dva povećanja, minimalna zarada u januaru 550 evra," 19 August 2025, <https://www.mfin.gov.rs/sr/aktivnosti-1/sinia-mali-nakon-dva-poveanjanja-minimalna-zarada-u-januaru-550-evra-1>

Përqindja prej rreth 36% e të punësuarve me orar të plotë që preken nga rritja është shumë e lartë. Kjo nuk tregon vetëm rëndësinë sociale të pagës minimale. Ajo tregon edhe se shumë vende pune në Kosovë janë të përqendruara në fund të shkallës së pagave, me produktivitet, kualifikim dhe fuqi negociuese të kufizuar. Për ta vendosur këtë debat në kontekst evropian, krahasimi nuk duhet të kufizohet vetëm të shumën nominale të pagës minimale. Duhet parë edhe raporti i saj me pagën mediane, mbulimi i punëtorëve, forca e dialogut social dhe niveli i zbatimit.

Tabela 1. Paga minimale në Kosovë në kontekst evropian: tregues krahasues dhe implikime

Treguesi krahasues	Çka tregon për Kosovën
Pagat minimale në BE	Në janar 2026, 22 nga 27 shtetet e BE-së kishin pagë minimale kombëtare. Pesë shtete - Danimarka, Italia, Austria, Finlanda dhe Suedia - nuk kanë pagë minimale kombëtare dhe mbështeten më shumë në marrëveshje kolektive. [6]
Niveli nominal	Në BE, paga minimale mujore bruto varioje nga 620 euro në Bullgari deri në 2,704 euro në Luksemburg. Paga minimale prej 500 eurosh në Kosovë mbetet nën nivelin më të ulët të BE-së në terma nominalë, edhe pse krahasimi duhet të marrë parasysh dallimet në çmime dhe produktivitet. [7]
Raporti me pagën mediane	Sipas Eurostat, në vitin 2024 raporti i pagës minimale me pagën mediane bruto në vendet e BE-së sillet nga 44% në Estoni deri në 69% në Portugal. Ndërsa sipas Institutit GAP, paga minimale bruto prej 350 eurosh në Kosovë përbënte 57.4% të pagës mediane bruto prej 609 eurosh, para rritjes së pagës minimale në 500 euro.[8]
Pesha e punëtorëve të prekur	Në Kosovë, rreth 36% e të punësuarve me orar të plotë pritet të preken nga rritja në 500 euro.[9] Kjo përqindje e lartë sugjeron se një pjesë e madhe e punësimit në Kosovë është e përqendruar në fund të shkallës së pagave. Për këtë arsye, rritja e pagës minimale duhet të shoqërohet me politika për rritjen e produktivitetit, aftësimin profesional dhe krijimin e vendeve më të kualifikuara të punës.

[6] Eurostat, “Minimum Wage Statistics,” *Statistics Explained*, të dhënat e nxjerra në janar 2026, qasur më 2 korrik 2026, https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Minimum_wage_statistics

[7] Eurostat, “Minimum Wage Statistics,” *Statistics Explained*, seksioni “Variations in national minimum wages,” të dhënat e nxjerra në janar 2026, qasur më 2 korrik 2026, https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Minimum_wage_statistics

[8] Eurostat, “Minimum Wage Statistics,” *Statistics Explained*, seksioni “Minimum wage levels in relation to median gross earnings,” të dhënat e nxjerra në janar 2026, qasur më 2 korrik 2026 dhe Institutit GAP, Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale. https://www.institutigap.org/documents/83097_Pagaminimale.pdf

[9] Po aty;

Në rajon, krahasimi tregon se Kosova nuk duhet ta trajtojë pagën minimale vetëm si garë për shumën më të lartë. Çështja kryesore është nëse paga minimale përcaktohet përmes një formule të qartë, nëse zbatohet realisht, nëse nuk rrit informalitetin dhe nëse shoqërohet me politika për më shumë punë të kualifikuar.

Prandaj, lufta për më shumë vende pune duhet të bëhet krahas luftës për më shumë vende të kualifikuara të punës. Një ekonomi ku një pjesë shumë e madhe e punëtorëve preken nga paga minimale është ekonomi që ka nevojë jo vetëm për rritje pagash, por edhe për transformim të strukturës së punësimit.

Rreziqet kryesore në zbatim

Suksesi i këtij vendimi nuk mund të matet vetëm përmes ndryshimeve të regjistruara në kontratat e punës ose në deklaratimet e pagave. Ai duhet të matet me shumën që punëtorët e marrin realisht.

Qeveria, Administrata Tatimore dhe Inspektorati i Punës duhet të parandalojnë rastet kur punëdhënësit e deklarojnë formalisht pagën prej 500 eurosh, por e shmangin detyrimin ligjor përmes praktikave të paligjshme, si:

- zvogëlimi formal i orarit të deklaruar të punës, pa zvogëluar kohën reale të punës;
- regjistrimi i punëtorëve me orar të plotë si të punësuar me orar të pjesshëm;
- pagesa e pagës ligjore përmes llogarisë bankare, duke i kërkuar punëtorit që një pjesë të shumës ta kthejë në para të gatshme;
- zëvendësimi i marrëdhënies së rregullt të punës me marrëveshje joformale ose kontrata fiktive;
- largimi i punëtorëve nga puna dhe ripunësimi i tyre me kushte më pak të sigurta.

Instituti kërkon një plan të koordinuar zbatimi, i cili duhet të përfshijë inspektime të orientuara në sektorët më të prekur nga rritja, kanale të sigurta për raportimin e shkeljeve dhe publikimin e rregullt të të dhënave për nivelin e respektimit të ligjit, sipas sektorëve ekonomikë dhe komunave. Kjo është veçanërisht e nevojshme në sektorin privat dhe në sektorët me nivel të ulët ose pa organizim sindikal, ku punëtorët kanë më pak mundësi për mbrojtje kolektive dhe janë më të ekspozuar ndaj praktikave të shmangies së detyrimeve ligjore.

Një pagë minimale që nuk monitorohet në mënyrë efektive rrezikon t'i ndajë punëtorët në dy grupe: ata që mbrohen nga ligji dhe ata, cenueshmëria e të cilëve u lejon punëdhënësve ta anashkalojnë atë.

Efekti në strukturën e pagave

Paga e re minimale do të krijojë në mënyrë të pashmangshme presion për rritjen e pagave të punëtorëve që aktualisht fitojnë pak më shumë se 500 euro. Kjo është pasojë normale e ngjeshjes së diferencave ndërmjet pagave.

Kur pagat e vendeve fillestare të punës dhe të punëve me kualifikim më të ulët afrohen me pagat e punëtorëve me përvojë, të kualifikuar ose mbikëqyrës, këta të fundit do të kërkojnë rritje që ruajnë vlerën e kualifikimit, përgjegjësisë dhe përvojës profesionale. Prandaj, ndikimi i vendimit do të shtrihet përtej punëtorëve që përfitojnë drejtpërdrejt nga minimumi ligjor.

Kjo çështje është veçanërisht e dukshme në sektorin publik. Duke u bazuar në koeficientët e përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në vlerën e koeficientit prej 110 eurosh dhe në shtimin prej një njësie të koeficientit të aplikuar gjatë vitit 2025, ^[9]paga bazë mujore bruto për disa pozita është afërsisht si më poshtë:

Tabela 1. Paga minimale në Kosovë në kontekst evropian: tregues krahasues dhe implikime

Pozita	Koeficienti në ligj	Pas shtimit +1	Llogaritja	Paga bazë bruto
Zyrtarë policor	5	6	6.0×110	€660
Mësimdhënës në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët	5.6	6.6	6.6×110	€726
Mësimdhënës në arsimin e mesëm të lartë	5.8	6.8	6.8×110	€748

Këto përlllogaritje nuk përfshijnë shtesën për përvojën e punës dhe shtesat e tjera të zbatueshme. Paga minimale prej 500 eurosh përbën, rrjedhimisht, afërsisht 76% të pagës bazë të një zyrtari policor, 69% të pagës së një mësimdhënësi në arsimin fillor ose të mesëm të ulët dhe 67% të pagës së një mësimdhënësi në arsimin e mesëm të lartë.

Kjo nuk dëshmon se paga minimale është tepër e lartë. Ajo dëshmon se pagat e disa profesioneve të kualifikuara dhe shoqërisht të domosdoshme janë bërë gjithnjë e më të ngjeshura.

Mësimdhënësit, zyrtarët policorë, infermierët, personeli teknik dhe profesionistët e tjerë të shërbimit publik nuk duhet të vendosen përballë punëtorëve me pagë minimale. Problemi nuk është se punëtorët në fund të shkallës së pagave marrin shumë. Problemi është se Kosovës i mungon një strukturë koherente e pagave, e cila i njeh në mënyrë adekuate kualifikimin, përgjegjësinë, rrezikun dhe përvojën.

Çfarë duhet të monitorohet pas hyrjes në fuqi?

Përveç inspektimeve, Qeveria duhet të publikojë një pasqyrë periodike me indikatorë të qartë për zbatimin e pagës minimale. Kjo do ta bënte debatin më të saktë dhe do të tregonte nëse rritja po zbatohet realisht apo vetëm formalisht. Monitorimi nuk duhet të kufizohet vetëm në deklarimin e pagës në kontrata, por duhet të përfshijë edhe mënyrën se si ndryshojnë praktikën e punësimit pas hyrjes në fuqi të vendimit. Për këtë arsye, Instituti propozon që institucionet përgjegjëse të ndjekin rregullisht disa indikatorë kyç:

Indikator	Pse është i rëndësishëm
Kontratat me orar të pjesshëm	Tregon nëse punëtorët me orar të plotë po regjistrohen fiktivisht si punëtorë me orar të pjesshëm.
Deklarimet e pagave nën ose pranë minimumit	Tregon nëse paga minimale po zbatohet në sektorët më të prekur dhe nëse ka lëvizje artificiale të pagave.
Ankesat e punëtorëve dhe rezultatet e inspektimeve	Tregon nivelin e shkeljeve dhe sektorët ku ka nevojë për mbikëqyrje më të fortë
Punësimi i të rinjve dhe punëtorëve me kualifikime të ulëta	Tregon nëse rritja krijon pengesa hyrëse për grupet më të cenueshme në tregun e punës
Efekti te ndërmarrjet e vogla	Tregon nëse rritja po përballohet nga bizneset e vogla pa rritur informalitetin ose pa ulur sigurinë e punës.

Përfundim dhe Rekomandime

Rritja e pagës minimale është hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të kushteve të punës në Kosovë. Por ky vendim duhet të shoqërohet me zbatim të fortë institucional, transparencë më të madhe dhe politika më të gjera për rritjen e cilësisë së vendeve të punës.

Paga minimale nuk duhet parë si masë e izoluar, por si pjesë e një politike më të drejtë dhe më të qëndrueshme të punësimit dhe pagave. Vetëm në këtë mënyrë ajo mund të mbrojë punëtorët me pagat më të ulëta, pa e lënë të pazgjidhur problemin më të madh: strukturën e dobët të punësimit dhe mungesën e një sistemi koherent të pagave në Kosovë.

Instituti Për Politika Sociale Musine Kokalari rekomandon:

- Përlllogaritja e pagës minimale të jetë transparente. Qeveria duhet të publikojë kriteret dhe formulën mbi të cilat përcaktohet paga minimale, duke përfshirë raportin me pagën mediane, koston e jetesës, produktivitetin, inflacionin dhe ndikimin në punësim. Kjo qasje përputhet me parimet e përcaktimit transparent dhe të rregullt të pagave minimale të rekomanduara në kornizën evropiane. ^[1]
- Të rikthehet roli i Këshillit Ekonomik-Social. Vendimet për pagën minimale duhet të kalojnë përmes dialogut social dhe konsultimit të rregullt me sindikatat, punëdhënësit dhe institucionet përgjegjëse.
- Të hartohet plan i përbashkët monitorimi. Administrata Tatimore dhe Inspektorati i Punës duhet të koordinojnë inspektime të synuara në sektorët më të prekur nga rritja, sidomos në tregti, shërbime, ndërtimtari dhe industri të ushqimit.
- Të krijohen kanale të sigurta për raportim. Punëtorët duhet të kenë mundësi të raportojnë shkelje pa frikë nga hakmarrja, largimi nga puna ose përkeqësimi i kushteve të punës.
- Të publikohen të dhëna periodike për zbatimin. Institucionet duhet të publikojnë rregullisht të dhëna për respektimin e pagës minimale sipas sektorëve, komunave, llojit të kontratës dhe orarit të punës.
- Të vlerësohet ndikimi te punësimi, çmimet dhe informaliteti. Çdo rritje e ardhshme duhet të mbështetet në analiza të përditësuara mbi punësimin, veçanërisht të të rinjve dhe punëtorëve me kualifikime të ulëta, si dhe mbi ndryshimet në çmime dhe informalitet.
- Të rishikohet struktura e pagave në sektorin publik. Qeveria duhet të analizojë ngjeshjen e pagave dhe të vlerësojë nëse pagat në profesionet e kualifikuara, me përgjegjësi dhe rrezik të lartë, reflektojnë në mënyrë adekuate vlerën e punës.
- Të lidhet paga minimale me politika për punë të kualifikuara. Rritja e pagës minimale duhet të shoqërohet me politika aktive të punësimit, aftësim profesional dhe mbështetje për sektorët që krijojnë vende pune më të kualifikuara dhe më produktive.



Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari është një institut i pavarur hulumtues në Kosovë, që promovon vlerat demokratike dhe sociale përmes politikave progresive. Synimi ynë është të ndërtojmë një shoqëri të drejtë, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, që përqafon diversitetin, forcon kohezionin shoqëror dhe mbështet vlerat qytetare të përbashkëta për të gjithë. Puna jonë fokusohet në avancimin e të drejtave të grave dhe punëtorëve, shpërndarjen e drejtë të pasurisë, qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut dhe minoriteteve, drejtësinë mjedisore dhe bashkëpunimin rajonal.

www.musineinstitute.org

info@musineinstitute.org